



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 99, datë 13.06.2018**

**PËR**  
**MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË Z. GENC KOXHAJ SI ADMINISTRATOR I**  
**SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SICRED” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 21 dhe 25 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/mbikëqyrjes, administratorit/anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes të Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e riemërimit të z. Genc Koxhaj, në funksionin e Administratorit të shoqërisë së sigurimit “SiCRED” sh.a., për një afat 3-vjeçar, nga data 18.05.2018, deri në datë 18.05.2021.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**